

Funksioni : 06 Strehimi dhe komoditetet e komunitetit

Nënfunksioni 061: Urbanistika

Programi 06140 : Planifikimi urban vendor

Vështrim i përgjithshëm		
Planifikimin dhe zhvillimin i banesave të përshtatshme në njësinë vendore.		
Emri i Programit	Përshkrimi i programit	Përshkrimi i programit
06140	Planifikimi Urban Vendor	<ul style="list-style-type: none"> Zhvillim, përditësim, bashkërendim dhe monitorim i planeve të zhvillimit urbanistik; Planifikim, administrim, zhvillim dhe kontrolli i territorit, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj. Grante, hua ose financime për të mbështetur zgjerimin, përmirësimin ose mirëmbajtjen e stokut të banesave; Lëshimi i lejeve për ndërtime të reja; zhvillimi i tokës dhe veprimtari të tjera që ndikojnë në urbanistikën e njësisë së vetëqeverisjes vendore. Administrim, bashkërendim dhe monitorim i planeve të përgjithshme, planeve, programeve dhe buxheteve të lidhura me strehimin; Shpërndarje e informacionit publik, dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet e strehimit; Sigurimi i trullit të nevojshëm për ndërtime banesash; ndërtim ose blerje dhe rimodelim i njësive banuese për publikun në përgjithësi ose për njerëz me nevoja të posaçme; eliminim i ndërtimeve të degraduara i lidhur me sigurimin e strehimit. Planifikim i përgjithshëm duke përfshirë formulimin, përditësimin, bashkërendimin dhe monitorimin, të Planeve të Përgjithshme Vendore /Planeve të Zhvillimit Strategjik; Hartimi i planeve të zonimit dhe i rregullave të ndërtimit;

Projekte të rëndësishme				
Kodi i projektit	Titulli dhe përshkrimi i kurtër i projektit	Buxheti 2019 (000 Lek)	Fillon	Mbaron
P06140.O1.A1	Përgatitja e PDV përzonat e parashikuara në PPV.	2,146	2019	2021
P06140.O1.A2	Publikimi i Planeve të Detajuara Vendore nepermjet publikimit elektronik dhe mjeteve tradicionale të informimit.		2019	2021
P06140.O2.A1.	Rivlerësimi, realizimi dhe monitorimi i Sistemit të Adresave Bashkia Shkodër		2019	2021



BASHKIA
SHKODËR

	Total	2,146		
--	--------------	--------------	--	--

Qëllimet	Objektivat	Treguesit e rezultatit	Synimet			
			2018	2019	2020	2021
Strategjitë unifikuar për zhvillimin e integruar të territorit në funksion të krijimit të një rajoni shumëqendërsh për meskrijimi të zhvillimit të infrastrukturës publike, administrative, sociale dhe kulturore...	O1. Hartimi, mbështetja dhe monitorimi i proceseve të planifikues në Bashkinë Shkodër, me qëllim sigurimin e kornizës së përgjithshme të zhvillimit të territorit dhe promovimit të tij.	Nr i PDV-ve; Nr Projektet të Aplikuara Nr Projektet të Zbatuara Nr Aktorët të Angazhuar Shuma e Fondeve të Përfutuara	Planii Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Shkodër në përputhje me instrumentat e planifikimit miratuar. Publikimii Planit të përgjithshëm Vendor Përfundim të rrethfaqen zyrtar të Bashkisë së Shkodrës dhe jetëvetë tjetër të informimit. Përgatitja e 4 PDV të nevojshme me qëllim implementimin e saktë të planit.	Përgatitja e 4 PDV për zonat e parashikuara në PPV. Implementimi i saktë i planit.	Përgatitja e 4 PDV për zonat e parashikuara në PPV. Implementimi i saktë i planit.	Përgatitja e 4 PDV për zonat e parashikuara në PPV. Implementimi i saktë i planit.
	O2. Realizimi dhe Monitorimi i Sistemit të Adresave sipas të përmirsimin e shërbimeve dhe identitetit të qytetarit	Realizimi i Sistemit të Adresave në Bashkinë Shkodër	Realizimi dhe zhornimii Sistemit të Adresave në të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër	Realizimi i 7 rrugëve dhe vendosja e tabelave.	Realizimi i 10 rrugëve dhe vendosja e tabelave.	Realizimi i 12 rrugëve dhe vendosja e tabelave.

Informacion financiar						
Vitet	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021
Tavani i përgjithshëm i programit				2,146	2,168	2,189
Shpenzimet bruto	-	-	13,349	2,146	2,168	2,189
Të ardhurat e programit	-	-	-	116	122	128
Shpenzimet neto	-	-	13,349	2,030	2,046	2,061
Pagat dhe sigurimet shoqërore				-	-	-
Investimet kapitale	-	-	13,349	2,146	2,168	2,189

Komente

Programi 06140: Planifikimi urban vendor, ka si burim financimi te ardhurat . Shpenzimet neto jane shpenzime qe mbulohen nga te ardhurat vetem per investime. Per vitet 2019,2020 dhe 2021,te gjitha shpenzimet jane ne trajten e shpenzimeve kapitale.

1.Përgatitja e PDV përzonat e parashikuar në PPV.
Kodinëmatricë P06140.O1.A1

01. Personat e Kontaktit

Emri I propozuesit të projektit	Bashkia e Shkodrës	Firma e propozuesit të Projektit	
Të dhëna të detajuara për propozuesin e projektit	Drejtoria Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve		
Institucioni Buxhetor/ Ministria/ grupi/ sektori	Bashkia Shkodrës	Vendodhja e Projektit	BashkiaShkodër

02. Identifikimi I Idesë së Investimit

Projekt Idea	Përgatitja e PDV për zonat e parashikuara në PPV	Viti 2019
Problemepërtuadresar	<p>Pas hartimit të PPV Shkodër, në mënyrë që të promovohet zhvillimi dhe të ndërtohet duhen hartuar dhe një sere planesh të përgjithshme vendore. Politika e Bashkisë është që zonat prioritare të zhvillohen me anë të planeve të detajuara vendore në mënyrë që të garantohet një zhvillim sa më harmonizuar I territorit. PDV do të hartohen nga stafi I bashkisë si dhe me kontraktim. Gjithashtu, pjesë e kontributit për hartimin e PDV do të vijë në marrëveshje edhe me zhvilluesit apo pale të tjera të interesuara bazuar në dispozitat ligjore në fuqi.</p> <p>Parashikohen një sërë PDV të rëndësishme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Velipojë - Rrjoll - Qëndër Shkodër - Shirokë-Zogaj - Z. Industriale 	
EmriiProgramit	Planifikimi urban	
Qëllimetdheobjektivat e programitcilatprojekti do tëndihmojëtarrihen	<ul style="list-style-type: none"> - Hartimi I Planeve të Detajuara Vendore - Harmonizim dhe koordinim - Zhvillim në bazë njësie 	

0.3. Kostot e ProjektitInvestimit

	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021
Kosto e projektimit	2 146	2 168	2 189
KostoTotale e Projektit - 000/lekë	2 146	2 168	2 189

04. Autorizuesit / Hapat e aprovimitëprojektdesë

	Emri	Nënshkrimi	Data	Qëllimi I rishikimit Statusi I Projektit Idesë
DrejtuesiiProgramit ne InstitucioninBuxhetor (IB)	Drejtoria Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit të			



	Investimeve			
Komente nga Drejtuesi i Programit (nqska)				
Sekretari i Përgjithshëm				Konfirmimi/ refuzimi i aprovimit të projekt idesë
Komente nga Sekretari i Përgjithshëm (nqs ka)				

2. Publikimi i Planeve të Detajuara Vendore nëpërmjet publikimit elektronik dhe mjeteve tradicionale të informimit.
Kodi në matricë: P06140.O1.A2

01. Personat e Kontaktit

Emri i propozuesit të projektit	Bashkia e Shkodrës	Firma e propozuesit të Projektit	
Të dhëna të detajuara për propozuesin e projektit	Drejtoria Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve		
Institucioni Buxhetor/ Ministria/grupi/sektori	Bashkia Shkodrës	Vendodhja e Projektit	Bashkia Shkodër

02. Identifikimi i Idesë së Investimit

Projekt Idea	Publikimi i Planeve të Detajuara Vendore nëpërmjet publikimit elektronik dhe mjeteve tradicionale të informimit.	Viti 2019
Problemet për tu adresuar	<p>Sipas përcaktimeve të Planit të Përgjithshëm Vendor, njësitë për të cilat do të hartohen plane të detajuara vendore janë SH010.UB, SH012.UB, SH017.UB, SH018.UB, SH019.UB, SH021.UB, SH025.UB, SH026.UB, SH027.UB, SH028.UB, SH029.UB, SH100.UB, SH103.UB, SH104.UB, SH105.UB, SH106.UB, SH108.UB, SH109.UB, SH110.UB, VL007.N, SH003.UB, SH004.UB, SH005.UB, SH006.UB, SH007.UB, SH008.UB, SH009.UB, SH015.UB, SH016.UB, SH041.UB, SH056.UB, SH057.UB, SH111.UB, SH112.UB, SH114.UB, VL002.UB, VL003.UB, VL004.UB, VL005.UB, VL006.UB, VL012.UB, VL013.UB, VL135.UB, VL137.UB. PDV-të kanë për qëllim, sipas rastit, të detajojnë përcaktimet e PPV-së, për: zhvillimin dhe/ose rihvillimin e një njësie; rigjenerimin/ripërtëritjen urbane; përdorimet e tokës dhe kushtet e zhvillimit; investimet publike në infrastrukturë apo shërbimet publike, që ndikojnë në ndryshimin ose rishpërndarjen e kushteve të zhvillimit; programet e drejtimit të zhvillimit nëpërmjet instrumenteve,</p> <p>Fillimi i procesit të punës për hartimin e PDV-së bëhet nga njësi vendore, me iniciativë të vetën nisur nga interesi publik për pajisje me infrastrukturë dhe shërbime apo me kërkesë të çdo pale të interesuar për zhvillim. Hartimi i dokumentit të PDV-së kryhet nga vetë autoriteti vendor për planifikimin dhe/ose nga pala e interesuar dhe në çdo rast procesi mbikëqyret në çdo hap nga struktura përgjegjëse e planifikimit të territorit të autoritetit vendor.</p> <p>Me nisjen e procesit të hartimit të PDV-së për secilën njësi strukturore, do të kryhet edhe këshillimi i PDV-së në të gjitha fazat, përmes botimit të dokumentit në regjistrë, informimit të palëve të interesuara dhe publikut nëpërmjet një a më shumë mjeteve tradicionale të informimit dhe përmes organizimit të takimeve publike me ta.</p>	
Emri i Programit	Planifikimi urban	
Qëllimet dhe objektivat e programit të cilat projekti do të ndihmojë të arrihen	<ul style="list-style-type: none"> - Publikimi i PDV - Këshillimi i PDV - Harmonizim dhe koordinim - Zhvillim në bazë njësie 	

0.3. Kostot e Projektit të Investimit

	Totali	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021
Kosto				



04. Autorizuesit / Hapat e aprovimit të projekt idesë

	Emri	Nënshkrimi	Data	Qëllimi i rishikimit <i>Statusi i Projektit Idesë</i>
Drejtuesi i Programit ne Institucionin Buxhetor (IB)	Drejtorja Studimeve, Planifikimit dhe Kordinimit të Investimeve			
Komente nga Drejtuesi i Programit (nqs ka)				
Sekretari i Përgjithshem				Konfirmimi/refuzimi i aprovimit të projekt idesë
Komente nga Sekretari i Pergjithshëm (nqs ka)				



3.Rivlerësimi, Realizimi dhe Monitorimi i Sistemit të Adresave Bashkia Shkodër
Kodi në matricë P06140.O2.A1

01. Personat e Kontaktit

Emripropozuesitëprojektit	BashkiaShkodër	Firma e propozuesitëProjektit	
Tëdhënatetajuarapërpropozuesin e projektit	DrejtoriaStudimeve, PlanifikimitdheKoordinimitëInvestimeve		
InstitucioniBuxhetor / Ministria/grupi/sektori	BashkiaShkodër	Vendodhja e Projektit	BashkiaShkodër

02. Identifikimiilidesë se Investimit

Projekt Idea	
Problemetpërtuadresuar	<p>Nëkuadërtëndryshimittëkufnijveadministrivtëbashkisë, sistemet e adresavetëNj.Ajanëtë pa integruarnëmenyreqëtëfunksionojnësinjëvetëm. Kjo problematikëibën jo funksionalsistemetekzistuese.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Qyteti Shkodër, NjA Velipoje, NjA Rrethina, NjA Ana e Malit, NjA Guri i Zi, NjA Dajç ka sistem adresash të miratuar, pjesa e mbetur e komunave nuk disponon sistem adresash të miratuar. - Për qytetin dhe njësitë e përmendura, është realizuar azhurnimi i objekteve të reja të ndërtuara në vitet e fundit. - Bashkia Shkodër aktualisht po përditëson sistemin hartografik elektronik të informacionit bazuar mbi verifikimin në territor.
EmriiProgramit	Planifikimi Urban
Qëllimetdheobjektivat e programittëcilatprojekti do tëndihmojëtarrihen	<ol style="list-style-type: none"> 1.Mbledhja e të dhënave të gjëndjes ekzistuese të tyre në gjithë territorin 2. Rivlersimi I sistemeve të adresave ekzistuese 3.Mirmbajtja dheazhurnimi I sitemit të adresave

0.3. Kostot e Projektit te Investimit

KostoTotale e Projektit 000/lekë	
---	--

Nenfunkcioni :062 Zhvillimi i komunitetit
Programi 06260: Shërbimet publike vendore

Emri i Programit	Përshkrimi i programit	Përshkrimi i programit
06260	Shërbimet publike vendore	<ul style="list-style-type: none"> • Planifikim i përmirësimit dhe zhvillimit të strukturave si: rekreacioni, hapësirat e përbashkëta dhe relaksuese për komunitetin; • Mbjellja e luleve, shkurreve dhe pemëve dekorative, të cilat përmirësojnë hapsirën e gjelbërt të njësisë së vetëqeverisjes vendore; • Zëvendësimi i trotuareve të prishura me material cilësorë që përmirëson hapsirën publike dhe rrit ci • lësinë e shërbimit ndaj qytetarëve. • Ndërtim, rehabilitim dhe mirëmbajtje e varrezave publike, si dhe garantimi i shërbimit publik të varrimit; • Parqet, lulishtet dhe hapësirat e gjelbra publike. • Të gjitha shërbimet e tjera publike sipas specifikimeve të çdo njësie të vetëqeverisjes vendore;

Projekte të rëndësishme				
Kodi i projektit	Titulli dhe përshkrim i shkurtër i projektit	Buxheti 2019	Fillon	Mbaron
P06260.O1.A1	Shpenzime për pagat, sigurime shoqërore dhe shpenzime operative për punonjësit e Shërbimeve Publike	27,928	2019	2021
P06260.O1.A2	Hartimi i planeve të veprimit për shërbimet publike	200	2019	2020
P06260.O2.A1	Shërbimi i mirëmbajtjes së varrezave publike dhe të dëshmorëve Qytet, NjA dhe varrezat e dëshmorëve.	10,009	2019	2021
P06260.O3.A1	Dekorimi i mjediseve publike	3,567	2019	2021
P06260.O4.A1	Ofrim i shërbimit të gjelbërimit në Bashkinë e Shkodrës	37,326	2019	2021
Totali		79,030		

Qëllimet	Objektivat	Treguesit e rezultatit	Synimet			
			2018	2019	2020	2021
<p>I.Garantimi për të gjithë qytetarët e saj shërbime publike cilësore në të gjithë territorin e saj pamvarësisht vendodhjes së tyre. II.Permirësimi i efencës dhe efektivitetit të shërbimeve publike, modernizimi i tyre nëpërmjet permirësimit të vazhdueshëm të teknologjisë III.Rritja e transparencës në lidhje me ofrimin e shërbimeve publike, dhe të sigurojë pjesëmarrjen e publikut në procesin e planifikimit dhe ta orientojë atë sipas</p>	<p>O1.Përbushja e nevojës për kryerjen e shërbimeve ditore të ruajtjes, pastrimit, mirëmbajtjes dhe të tjera për objektet dhe hapësirat publike.</p>	<p>Shërbime publike të ofruara në të gjithë territorin e Shkodrës</p>	<p>Ofrimi i shërbimeve të rojës, pastrimit të objekteve, mirëmbajtjes së objekteve administrative dhe të tjera sipas nevojës në Njësi Administrative</p> <p>Te dhëna të vlefshme për analizë dhe përpunim për hartimin e planeve të veprimit;</p>	<p>E njëjta qendrueshmeri</p> <p>2 plane të veprimit për shërbimet publike</p>	<p>E njëjta qendrueshmeri</p> <p>2 plane të veprimit për shërbimet publike</p>	<p>E njëjta qendrueshmeri</p> <p>2 plane të veprimit për shërbimet publike</p>
	<p>O2.Shërbim cilësor me standarde dhe sipas normativave të rregullores së Mirëmbajtjes së Varrezave. Zgjerim i territorit të Varrezave për vazhdimësinë e</p>	<p>Rregullore për mirëmbajtjen dhe funksionimin e Varrezave Publike.</p>	<p>Hartimi i një plani të integruar dhe i rregullores së brendshme për funksionimin e varrezave publike</p>	<p>Funksionimi i aktiviteteve të shërbimit funeral dhe mirëmbajtjes sipas rregullores</p>	<p>Funksionimi i aktiviteteve të shërbimit funeral dhe mirëmbajtjes sipas rregullores</p>	<p>Funksionimi i aktiviteteve të shërbimit funeral dhe mirëmbajtjes sipas rregullores</p>

<p>nevojave të qytetarëve. IV.Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e varrezave publike si dhe garantimi i shërbimit të varrimit;</p>	<p>këtij shërbimi .</p>	<p>Mirëmbajtja e varrezave publike Qytet. Zgjerimi i sipërfaqes për garantimin e shërbimit funeral.</p>	<p>Zgjerim i sipërfaqes për mirëmbajtje me 14 000 m2 nga 52 800 m2 në 66 800 m2</p>	<p>E njehta qendrueshmeri</p>	<p>Zgjerim i parcelave të reja të varrezave me 18 000 m2 nga 66 800 m2 në 84 800 m2</p>	<p>Zgjerim i parcelave të reja të varrezave me 10 000 m2 nga 84 800 m2 në 94 800 m2</p>
---	-------------------------	---	---	-------------------------------	---	---

	Përmirësimi i shërbimit të varrezave -Investime/shpenzime për përmirësimin e shërbimit të varrezave (ndryshimi në %);	E njehta qendrushmeri	E njehta qendrushmeri	E njehta qendrushmeri	E njehta qendrushmeri
O3. Shtimi i aktiviteteve festive që kanë nevojë për dekorim, duke ruajtur traditën dhe kulturën tonë	Përshtatja e dekorit të aktivitetit në lidhje me traditën dhe kulturën.	Krijimi i dekorit në të gjithë sheshet dhe rrugët kryesore ne zonat urbane për të gjitha Nj.A.	Krijimi i dekorit në të gjithë sheshet dhe rrugët kryesore ne zonat urbane për të gjitha Nj.A.	Krijimi i dekorit në të gjithë sheshet dhe rrugët kryesore ne zonat urbane për të gjitha Nj.A.	Krijimi i dekorit në të gjithë sheshet dhe rrugët kryesore ne zonat urbane për të gjitha Nj.A.
O4. Përmirësimi i cilësisë së mirëmbajtjes dhe riorganizimi i lulishteve, zgjerimi i sipërfaqeve të gjelbërta dhe gjelbërimit rrugor, në të gjithë Bashkinë.	Përmirësimi i shërbimeve publike vendore Rritja e mbulimit me shërbim: - Raporti i sipërfaqes së gjelbëruar kundrejt sipërfaqes publike të zonës urbane në rrugë, sheshe, trotuare e lulishte (në %) - Rrënjë pemë të mbjella kundrejt totalit të pemëve për të cilat kujdeset / fondi pemëve të bashkisë (në %) Rritja e efijencës buxhetore në ofrimin e shërbimeve publike - Lekë të ardhura nga tarifa e gjelbërimit kundrejt totalit të të ardhurave nga tarifat vendore (në %) - shpenzime për gjelbërimin për m2; Sipërfaqe të gjelbërta të mirëmbajtuara në m2; nr pemësh/drurë të mbjellë	9.2% sipërfaqe e gjelberuar kundrejt totalit të sipërfaqes publike urbane; 10% Rrënjë pemë të mbjella kundrejt totalit të pemëve për të cilat kujdeset / fondi pemëve të bashkisë; 7.33% zene te ardhurat nga nga tarifa e gjelbërimit kundrejt totalit të të ardhurave nga tarifat vendore; 300.4 lek/m2 shpenzime per gjelberimi; 116000 m2 sipërfaqe e gjelbert te mirembajtura;	10% sipërfaqe e gjelberuar kundrejt totalit të sipërfaqes publike urbane; 9% Rrënjë pemë të mbjella kundrejt totalit të pemëve për të cilat kujdeset / fondi pemëve të bashkisë; 7.48% zene te ardhurat nga nga tarifa e gjelbërimit kundrejt totalit të të ardhurave nga tarifat vendore; 295.1 lek/m2 shpenzime per gjelberimi; 126500 m2 sipërfaqe e gjelbert te mirembajtura;	10.3% sipërfaqe e gjelberuar kundrejt totalit të sipërfaqes publike urbane; 8% Rrënjë pemë të mbjella kundrejt totalit të pemëve për të cilat kujdeset / fondi pemëve të bashkisë; 7.48% zene te ardhurat nga nga tarifa e gjelbërimit kundrejt totalit të të ardhurave nga tarifat vendore; 293.91 lek/m2 shpenzime per gjelberimi; 129500 m2 sipërfaqe e gjelbert te mirembajtura;	10.5% sipërfaqe e gjelberuar kundrejt totalit të sipërfaqes publike urbane; 7% Rrënjë pemë të mbjella kundrejt totalit të pemëve për të cilat kujdeset / fondi pemëve të bashkisë; 7.47% zene te ardhurat nga nga tarifa e gjelbërimit kundrejt totalit të të ardhurave nga tarifat vendore; 290.7 lek/m2 shpenzime per gjelberimi; 132500 m2 sipërfaqe e gjelbert te mirembajtura;

Të dhënat e programit		2017	2018	2019	Trendi
Numri i stafit		78	78	78	78
Me kohe te plote		48	48	48	48
Shpenzime për ofrimin e shërbimeve publike Funeralet ne 000/leke		7,205	9,049	9,049	10,009
Hapësira rekreativiteti, sportive dhe argëtim (në metra katrorë)	Sipërfaqja e hapësirave të gjelbërta / parqe	94	102	105	105
Shpenzime për hapësirat rekreative, argëtim dhe sport	Shpenzime për parqe, gjelbërim	33,170	36,500	36,530	38,056
Të ardhura nga tarifa e gjelbërimit		21,627	21,509	21,510	22,000

Informacion financiar						
Vitet	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021
Tavani i përgjithshëm i programit				79,030	80,546	81,523
Shpenzimet bruto	60,131	59,446	106,831	79,030	80,546	81,523
Të ardhurat e programit	20,442	21,627	21,509	21,910	22,022	22,135
Shpenzimet neto	39,689	37,819	85,322	57,120	58,524	59,388
Pagat dhe sigurimet shoqërore				29,315	29,901	30,273
Investimet kapitale	-	175	14,542	-	-	400

Komente

Programi 06260: Shërbimet publike vendore, ka si burim financimi kryesisht transfertën e pakushtezuar dhe të ardhurat. Të ardhurat nga tarifatat me destinacion vijnë nga gjelbërimi me një mesatare prej 28.7%. Ndërsa shpenzimet neto janë shpenzime që mbulojnë nga transfertat e pakushtezuar dhe të ardhurat e tjera. Pjesën më të madhe të shpenzimeve e zënë shpenzimet korentë me rreth 62.9% në vitin 2019, 62.9% në vitin 2020 dhe 62.4% për vitin 2021. Ndërsa shpenzimet për paga dhe sigurime zënë 37.1% për vitet 2019, 2020, 2021. Shpenzimet kapitale zënë 0% në vitin 2019, 0% në vitin 2020 dhe 0.5% në vitin 2021.



Nr. 1	P06260.01.A1 Shpenzime për pagat, sigurime shoqërore dhe shpenzime operative për punonjësit e Shërbimeve Publike	Funksioni 6: Strehimi dhe komoditeti i komunitetit N/Funksioni 062: Zhvillimi i Komunitetit Llojet e programit: 06260: Shërbimet Publike Vendore				
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit						
i. Situata						
<ul style="list-style-type: none"> Paga dhe shtesat për punonjës mbështetes shërbimi, mirëmbajtje, pastrim, heqje mbeturina urbane, roje Zbatimi i Buxhetit për shpenzime personeli, do të bazohet tek numri i punonjësve dhe nivelet e pagave si pas klasave të shtesave mbi pagë, në përputhje me aktet nënligjore në fuqi, brenda kufirit minimal dhe maksimal të miratuar. Paga, shtesat mbi pagat e punonjësve, bëhen sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.165 datë 02.03.2016 "Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrative të njësive të vetëqeverisjes vendore", duke u bazuar në sistemin me klasat e përshtatur sipas VKM nr 717, datë 23.6.2009 të Këshillit të Ministrave "Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore", të ndryshuar. Planifikimi i fondit të pagave dhe sigurimeve shoqërore për vitin 2019, është në shumën 27 748 mijë lekë, nga të cilat 23 940 mijë lekë për paga dhe 3 808 mijë lekë për sigurime shoqërore. Numri i plotë punonjësve me kohë të plotë është 45, ndërsa me kohë të pjeshshme është 30 punonjës. Kontributi për sigurime shoqërore dhe shëndetësore Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore do të jetë në zbatim të ligjit Nr. 7703, datë 11. 05. 1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe të ligjit Nr. 7870, datë 13. 10. 1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar". 						
ii. Synimi i projektit						
Garantimi i shpenzimeve të pagave, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të punonjësve të shërbimeve publike Përbushja e nevojës për kryerjen e shërbimeve ditore të ruajtjes, pastrimit, mirëmbajtjes dhe të tjera, për objektet dhe hapësirat publike.						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
Sigurimi i shpenzimeve <ol style="list-style-type: none"> Paga, Sigurime shoqërore dhe shëndetësore, për administratën vendore Blerje material të ndryshme për punonjësit e njësive të ofrimit të shërbimeve, si për shembull: (furça, elektroda, komplet punta hekuri, maskë saldimi, punta betoni, dalta, tarpon, matrapik, etj) Paisje me dokumentin e sigurimit teknik për punonjësit e njësive të ofrimit të shërbimeve 						
b) Rezultatet priturme						
Shpërblimi në mënyrë sistematike dhe korrekte për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore të administratës vendore në mbështetje të përbushjes së detyrave dhe funksioneve me profesionalizëm, korrektësi dhe transparencë. Efektivitet të plotë të punës së punëtorëve të njësive të ofrimit të shërbimeve Mirëmbajtja e të gjithë objekteve në qytet dhe në Nj.A Mirëmbajtje e ambienteve publike në Nj.A						
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt		
<ol style="list-style-type: none"> Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse Drejtoria e Financës 				Bashkia Shkodër		
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet viti 2019		Total (000 lek)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operati ve	Transfe rta Kapita le
A.1.1/1	Paga dhe shtesat mbi paga	23 940	23 940			
A.1.1/2	Kontributi për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	3 808		3 808		
A.1.2	Paisje me dokumentin e sigurimit teknik për punonjësit e njësive të ofrimit të shërbimeve	60			60	
A.1.3	Blerje materiale të ndryshme për punonjësit e njësive të ofrimit të shërbimeve	120			120	
TOTALI		27 928	23 940	3 808	180	
Nga kjo:						



Shpenzimet për çdo aktivitet viti 2020		Total (mijë lekë)	Paga	Sigurime	Operati ve	Transfe rta	Kapital e
A.1.1/1	Paga dhe shtesat mbi paga	24 420	24 420				
A.1.1/2	Kontributi për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	3 883		3 883			
A.1.1/3	Kompensime për kryefamiljarë me ngarkesë më shumë se 3 fëmijë	180				180	
A.1.2/1	Blerje materiale të ndryshme për punonjësit e njësisë së ofrimit të shërbimeve	400			400		
TOTALI		28 883	24 420	3 883	400	180	
Shpenzimet për çdo aktivitet viti 2021		Total (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operati ve	Transfe rta	Kapital e
A.1.1/1	Paga dhe shtesat mbi paga	24 682	24 682				
A.1.1/2	Kontributi për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	3 961		3 961			
A.1.1/3	Kompensime për kryefamiljarë me ngarkesë më shumë se 3 fëmijë	180				180	
A.1.2/1	Blerje mjete të ndryshme për punonjësit e njësisë së ofrimit të shërbimeve	400					400
Totali		29 223	24 682	3 961		180	400
f) Periudha e zbatimit		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:					
Gjatë viteve 2019-2021		Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër					



Nr. 2	P06260.O1.A2 Hartimi i planeve të veprimit për shërbimet publike	Funksioni 6: Strehimi dhe komoditeti i komunitetit N/Funksioni 062: Zhvillimi i Komunitetit Llojet e programit: 06260: Shërbimet Publike Vendore
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:		
i. Situata		
<p>Bashkia Shkodër në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” është përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve publike si: shërbimi i pastrimit, shërbimi i gjelbërimit, shërbimi i ndriçimit publik, shërbimi i mirëmbajtjes së rrjetit të kanaleve kulluese dhe vaditëse, mirëmbajtja e rrugëve, e infrastrukturës së institucioneve të arsimit parashkollor dhe shkollor, etj.</p> <p>Për herë të parë në vitin 2017, me qëllim përmirësimit të shërbimit, Bashkia Shkodër ndërmori iniciativën për realizimin e Planit të Veprimit për përmirësimit të shërbimit të kullimit, si një dokument për analizën, planifikim afatmesëm, dhe për matjen e performancës së ofrimit të shërbimit.</p> <p>Pas reformës territoriale, lind nevoja për një administrim sa më të mirë të burimeve, me efektivitet dhe efikasitet, sipas prioriteteve dhe nevojave të vlerësuara nga qytetarët dhe teknikienët.</p> <p>Plan i veprimit për përmirësimit të shërbimit të caktuar public hartohet bazuar në metodologjinë e punës në grup dhe përmes një procesi pjesëmarrës. Ky proces realizohet përmes procesit të përshruar më poshtë.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ngritja e grupit të punës për hartimin e dokumentit • Analiza e situatës aktuale të shërbimit, infrastrukturës, etj. • Baza ligjore dhe institucionale; • Përshkrimi i gjendjes • Të dhëna teknike dhe specifikime të shërbimit; • Shtrimi i problemeve; • Përshkrimi i përgjithshëm dhe qëllimi i planit të veprimit për përmirësimit të shërbimit • Vlerësimi me vëzhgues të kualifikuar rezultatet e vlerësimit të shërbimit me anketa (pyetsor) me qytetarët; • Kapacitete lokale për ofrimin e shërbimit (mirëmbajtje, apo investim); • Misioni ,objektivat dhe aktivitetet e planit të veprimit për shërbimin; • Komunikimi me publikun <p>Plani i veprimit për përmirësimit të shërbimit është dokument që shërben si një instrument shumë i rëndësishëm për menaxhimin me cilësi , efikasitet dhe efikasitet të shërbimit publik.</p> <p>Ky dokument përcakton gjithaëshu edhe metodën e manaxhimit të performancës, matjes së rezultateve nepermjet indikatorëve si dhe mundëson alokimin e buxhetit përmes një procesi dhe vendimarrje me pjesëmarrje.</p> <p>Në vitin 2018, Bashkia Shkodër parashikon hartimin e Planit të veprimit për përmirësimit të shërbimeve publike si: shërbimi i gjelbërimit, shërbimi i mirëmbajtjes së infrastrukturës së objekteve shkollore, shërbimi i mirëmbajtjes së rrugëve, shërbimi i ndriçimit, etj.</p> <p>Nga ekspertiencia e realizuar gjatë hartimit të planit të veprimit për përmirësimit të shërbimit të kullimit në Bashkinë Shkodër, ky proces realizohet për një periudhë 1-2 mujore.</p> <p>Bashkia Shkodër do të angazhojë stafin e vet sipas përgjegjësisë, specialistët dhe drejtuesit e niveleve përgjegjës, drejtor, nënryetar dhe kryetar, përfaqësuesit e komunitetit, të rinjtë, pse jo edhe student të universitetit të Shkodrës. Ky proces do të kërkojë edhe mbështetjen me ekspertizë rreth 15-20 dite punë për proceset e trajnimit, mbështetjen në ëorkshope apo seminare teknike, si dhe përpunimin e të dhënave.</p>		
ii. Synimi i projektit		
<ul style="list-style-type: none"> • Hartimi i një plani/planeve të qartë afatmesëm veprimi për përmirësimit të shërbimit publik/shërbimeve publike; 		
iii. Aktivitetet kryesore të projektit		
<ol style="list-style-type: none"> 1. Ngritja e grupeve të punës 2. Trainim 2 ditor për parimet dhe metodën e SIAP. (mund të behet në një ditë të gjatë) 3. Përgatitje format raportimi (ku ti jepet detyra e radhës për analizën e situatës si pas formatit dhe metodologjisë , radhës, elementeve përberes etj) 4. Përgatitje e tabelave financiare dhe të produktit (disagregimi i të dhënave dhe ndarja sipas strukturës raportuese.) 5. Shtrimi dhe analiza e problemeve 6. Vendosja e rezultateve që do arrihen dhe indikatorët matës 7. Mision, vizion, objektiva si dhe vendosja e objektivave të financimit , lidhja me produkt si dhe llogaritjet e efikasitetit. 8. Formatimi i pyetesoreve (për qytetarët dhe vëzhguesit e kualifikuar) 9. Mbledhja dhe përpunimi dhe agregimi i të dhënave 10. Plani veprimit 11. Organizimi i komunikimit me publikun; 		



<p>12. Tabela perfundimtare dhe me anekset për katëse; 13. Diskutimi dhe konsultimi përfundimtar nga këshilli i Bashkisë Shkodër; 14. Miratimi i Planeve të veprimit për përmirësimin e shërbimeve dhe rregulloreve përkatëse. dhe në Këshillin Bashkiak;</p>							
b) Rezultatet që prisni							
<ul style="list-style-type: none"> Hartimi i një plani/planeve të qartë afatmesëm veprimi për përmirësimin e shërbimit publik/shërbimeve publike; Rritje e performancës në menaxhimin dhe ofrimin e shërbimit; Proces me pjesëmarrje për hartimin e planit-analiza – misioni-vizioni-objektivat e matshëm-prioritetet e aktiviteteve-burimet e financimit; Sistem i qëndrueshëm për raportimin dhe monitorimin e shërbimeve publike; Komunikim transparent me publikun; Minimizim i korrupsionit të mundshë, si një risk në administratën publike; Përvetësimin e metodologjisë së punës nga ana e administratës së angazhuar në Bashkinë Shkodër; Rritje e kapaciteteve të administrimit të shërbimit të administratës me përgjegjësi dhe të angazhuar në process 							
c) Aktorët e mundshëm			d) Kontributet e mundshme në projekt				
Drejtoria e Shërbimeve publike, ndjekjes së Investimeve dhe Infrastrukturës Drejtoria Ekonomike e Arsimit, Drejtoria e Buxhetit; Drejtoria e Financës; etj: sipas fushës përkatës të shërbimit publik dhe nevojës për bashkëpunim,			Bashkia e Shkodrës Ekspertë të fushës;				
e) Shpenzimet e llogaritura							
Shpenzimet për çdo aktivitet 2019			Totali (mije lekë)	Nga kjo:			Kapitale
				Pag a	Siguri me	Operat ive	
A.1	Ekspertë të fushës (honorar 2700lekë/ orë)		200			200	
Shuma 2019			200			200	
f) Periudha e zbatimit Viti 2019			g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Nënryetarët sipas fushës së përgjegjësisë; Drejtoritë përkatëse sipas fushës së përgjegjësisë së shërbimit; Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër				



Nr. 3	P06260.O2.A1 Mirëmbajtje e varrezave publike dhe varrezave të dëshmorëve..	Funksioni 6: Strehimi dhe komoditeti i komunitetit N/Funksioni 062: Zhvillimi i Komunitetit Llojet e programit: 06260: Shërbimet Publike Vendore
a) Përshkrim i shkurtër i projektit		
i. Situata		
Shërbimi i mirëmbajtjes së Varrezave Publike . Gjatë vitit 2018 është realizuar mirëmbajtja e varrezave publike në Bashkinë Shkodër me sipërmarrje private me kontratë 3-vjeçare e lidhur me date 15.05.2018. Shërbimet kryesore që kryhen janë: <ul style="list-style-type: none">• Pastrim parcelash dhe rrugësh të brendshme ndërmjet parcelave me sipërfaqe 52.312 m²• Mbjellje drurësh dekorativ 41 copë.• Mbjellje në parcela bordurë e gjelbert, 250 m².• Shërbimi i ruajtjes për varrezat publike dhe ato të dëshmoreve. Është realizuar shpronësimi i sipërfaqes së tokës duke krijuar kushtet për krijimin e parcelave të reja për kryerjen e shërbimit funeral. Kjo sipërfaqe në kushte normale siguron shërbimin funeral edhe për 7 vite te ardhëshme. Është realizuar investimi për ndërtimin e parcelave të reja në territorin e shpronësuar dhe ndërtimin e rrugëve të brendshme. Ky investim në këto parcela siguron kryerjen e shërbimit funeral për dy vite të tjera. Njëkohësisht është realizuar investimi për rrethimin e parcelave të reja. <u>Situata e Vlerësuar:</u> <ul style="list-style-type: none">• Nuk ka një Plan veprimi për ofrimin e shërbimit publik të varrezave. Pjesë e shërbimit mungon një rregullore e përditësuar për ofrimin e shërbimit publik të varrezave.• Shpesh ka vështirësi në administrimin të territorit sipas rregullores së funksionimit te varrezave publike, pasi varrezat nuk kanë rrethim të plotë në pjesën e parcelave të vjetra. Kjo shkakton vështirësi në kontrollin e territorit dhe lëvizje të pakontrolluara të kalimtarëve.• Në pjesën më të madhe të njësive, administrimi i varrezave bëhet nga vetë komunitetet apo nga institucione fetare.• Bashkia Shkodër ka angazhuar punonjës të shërbimeve të varrezave të pajisur me mjete përkatëse për ofrimin e shërbimit të mirëmbajtjes së varrezave në Njësitë administrative.• Në ndonjë nga njësitë administrative pjesë e Bashkisë Shkodër, kërkohet vlerësimi dhe planifikimi per shpronësim të hapësirave të reja në funksione të shërbimit të varrezave.		
ii. Synimi i projektit		
Viti 2019- 2020-2021 <ul style="list-style-type: none">• Ofrim i shërbimit publik të varrezave në 80 % të territorit administrativ të Bashkisë Shkodër.• Vazhdim i ofrimit nëpërmjet kontratës me operatorin për Nja Shkodër deri në përfundim të afatit të kontratës.• Vazhdim i ofrimit të shërbimit në NJA, përmes punonjësve publike të kontraktuar për këtë qëllim.• Gjatë vitit2019 Bashkia Shkodër do të fillijë punën për hartimin e planit të veprimit për të ofruar shërbim të standartizuar dhe me indikatorë të matjes së performancës për të gjithë territorin e Bashkisë së Shkodrës.• Për vitin 2019 e në vazhdim, do të fuqizojë bashkëpunimin me komunitetin, institucionet e besimeve fetare për një mbarëvajtje komunitare të këtij shërbimi në te gjithë territorin.• Gjatë viteve 2019 -2020 vlerësimi i nevojave për zgjerim territori për varreza në Nj.A, dhe realizimi i procedurave të shpronësimit.		
iii. Aktivitetet kryesore të projektit		
Viti 2019 <ul style="list-style-type: none">• Hartimi i Planit të veprimit dhe rregullores për ofrimin e shërbimit të mirëmbajtjes dhe administrimit të varrezave. . . Hartim dhe vënie në zbatim e sistemit të monitorimi ti standartizuar ne kuadër të plotësisimit të detyrimeve kontraktuale, apo detyrave të përcaktuara për strukturat publike të shërbimit. Vlerësimi i nevojave të NJA për zgjerim territori per varreza Viti 2020 – 2021 <ul style="list-style-type: none">• Realizim sipas përcaktimeve afatmesme të Planit të veprimit për shërbimin e varrezave:• Përmirësim i shërbimit të varrezave publike në Bashkinë Shkodër.• Rritje e i investimeve për shërbimin e varrezave publike.• Përmirësim i performancës së ofrimit të shërbimit përmes zbatimit dhe funksionimit të sistemit të monitorimit dhe rregullores.• Realizimi i procedurave të shpronësimit për zgjerim varreza në Nj.Administrative.		
b) Rezultatet që prisni		
Viti 2019 - 2021		



<ul style="list-style-type: none"> Një plan i saktë veprimi është hartuar, vihet në zbatim me një rregullore për administrimin e shërbimit për një periudhë afatmesme do të hartohet. Ky plan do të analizojë nëvojat, kostot, dhe do të përcaktojë në kohë afatmesme synimet dhe indikatorët e matshëm për performancën e ofrimit të shërbimit. Ofrim i shërbimit të standartizuar për varrezat publike. Rritje e performancës së ofrimit të shërbimit nëpërmjet një sistemi më efikas të matjes dhe monitorimit. <p>Zgjerim territori për varreza ne NJ.A</p>							
Shpenzimet për çdo aktivitet 2019		Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Siguri me	Operati ve	Transfe rime	Kapital e
A.1	Mirëmbajtje varreza publike të dëshmorëve Qytet dhe Nj.A.	9877			9877		
A.2	Karburant për prerëset e Barit për Nj.A (benzinë)	132			132		
Shuma		10009			10009		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2020		Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Siguri me	Operati ve	Transfe rime	Kapital e
A.1	Shërbimi i mirëmbajtjes së varrezave publike dhe të dëshmorëve Qytet, NjA dhe varrezat e dëshmorëve.	9877			9877		
A2	Karburant për prerëset e Barit për Nj.A (benzinë)	132			132		
A3	Rrethim , sistemim dhe asfaltim parcelat e vjetra						
Shuma		10009			10009		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2021		Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Siguri me	Operati ve	Transfe rime	Kapital e
A.1	Shërbimi i mirëmbajtjes së varrezave publike dhe të dëshmorëve Qytet, NjA dhe varrezat e dëshmorëve deri më 15.05.2021.	4803			4803		
A2	Tender i ri me kontrate 5-vjecare pas dates 15.05.2021 ,(me vlerë totale 58 000 lek)	5326			5326		
Shuma		10129			10129		
f) Periudha e zbatimit Gjatë viteve 2019-2021		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Shërbimeve Publike, Ndjekjes së investimeve të infrastrukturës Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër					



Nr. 4	P06260.O3.A1 Dekorimi i mjediseve publike	Funksioni 6: Strehimi dhe komoditeti i komunitetit N/Funksioni 062: Zhvillimi i Komunitetit Llojet e programit: 06260: Shërbimet Publike Vendore
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:		
i. Situata		
<p>Bashkia Shkodër realizon dekorin me burimet e veta financiare, me mjetet logjistike e fuqinë punëtore të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, ndjekjes së Investime dhe Infrastrukturës. Me financimet në buxhetin e vitit 2018 është realizuar blerja e aksesoreve të rinj me të cilët dekorohen sheshet dhe akset kryesore të qytetit. Pjesa tjetër e dekorit realizohet me elementë të investuar në vite, të cilët ruhen dhe mirëmbahen nga punonjësit e sektorit. Me këto elementë zbukurues dekorohen sheshet Parrucë, Nënë Tereza, Demokracia, Rus i madh, rrugët 13 Dhjetori, 28 Nëntori, Kolë Idromeno, Zogu i Parë, Studenti, Bulevardi Skënderbeg, Gjuhadol, Mehmet Pashë Plaku si dhe godina e Bashkisë e sheshi i saj. Puna realizohet me punonjësit e Drejtorisë së Shërbimeve Publike të cilët janë tre specialistë për dekorin që punojnë me kohë të plotë për realizimin e shërbimit dhe specialistat e ndriçimit që punojnë me kohë të pjesshme për dekorin në rastet e festave.</p> <p>Gjithashtu për dekorimin e mjediseve vihen në dispozicion edhe 2 autovinçat e ndriçimit në varësi të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, ndjekjes së Investime dhe Infrastrukturës.</p> <p>Puna që kryhet: Krahas punës për dekorimin e qytetit për festat e fund vitit, realizohet shërbimi edhe në rastet e festave të tjera zyrtare si dhe aktivitete të ndryshme të Bashkisë gjatë vitit, ku ndër më kryesoret janë aktivitetet tradicionale si 2 Prilli, Dita e Luleve, Dita e Karnevaleve, Festa e Pavarësisë, etj.</p> <p><u>Problemet e paraqitura</u> Në kontekstin e ri territorial të Bashkisë Shkodër, lind nevoja për shtrirjen e këtij shërbimi në njësitë administrative të bashkisë si dhe rritja e cilësisë së dekorit urban në të gjitha qendrat dhe sheshet urbane. Mungesa e dekorit për disa aktivitetet tradicionale. Amortizimi i elementëve zbukurues të blerë shumë vite më parë dhe nevoja për financime më të mëdha për ripertërtitjen e tyre me aksesore të rinj.</p>		
ii. Synimi i projektit		
Viti 2019 – 2020 – 2021 Përmirësimi i dekorit urban në qytet dhe njësitë administrative, sipas specifikave dhe traditave. Shtimi i numrit të aktiviteteve duke përfshirë edhe festat e ndryshme fetare me elementë dekorativ. Shtimi i sipërfaqeve të dekoruara me rastin e festave tradicionale.		
iii. Aktivitetet kryesore të projektit		
I. Dekorimi i mjediseve publike Viti 2019 Janë parashikuar shpenzimet sipas preventivave për dekorin e mjediseve publike për festat e fund vitit, festat e tjera zyrtare si dhe aktivitetet e ndryshme të Bashkisë gjatë vitit. <ol style="list-style-type: none"> Blerje aksesor dekorimi për festat: Blerja e aksesoreve shtesë, të cilët do të vendosen në sheshe e rrugë kryesore të Bashkisë. Pjesa tjetër e dekorit do të realizohet me aksesore të blerë në vitet e kaluara, të cilët ruhen e mirëmbahen nga punonjësit e sektorit. Me këto aksesore për festat e fundvitit do të realizohen dekorimi i akseseve kryesore të rrugëve të qytetit, dekorohen sheshet Parrucë, Nënë Tereza, Demokracia, Rus i madh, rrugët 13 Dhjetori, 28 Nëntori, Kolë Idromeno, Zogu i Parë, Studenti, Bulevardi Skënderbeg, Gjuhadol, Mehmet Pashë Plaku si dhe godina e Bashkisë e sheshi i saj. Blerje materiale të ndryshme për dekorin: <ul style="list-style-type: none"> Këtu përfshihen materialet e domosdoshme për riparimet e mundshme dhe montimin e aksesoreve të dekorit. Në zërat kryesore të shpenzimeve përfshihen: Kordon ndriçues dekorative (Ø 12 mm). Tel percjelles energjie elektrike me dimension 2x1.5 mm. Lidhëse kabllosh plastike. Blerje flamuj për dekorin e institucioneve administrative në të gjithë territorin si dhe në sheshe dhe rrugë kryesore. <p>Viti 2020 Do të parashikohet blerja e aksesoreve për festat e fundviti. Blerje flamuj.</p> <p>Viti 2021 Do të parashikohet blerja e aksesoreve për festat e fundviti. Blerje flamuj.</p>		
b) Rezultatet që prisni		



Viti 2019-2020-2021						
<ul style="list-style-type: none"> - Krijimi i dekorit më cilësor në të gjithë sheshet dhe rrugët kryesore në zonat urbane; - Krijimi i dekorit më cilësor festiv me rastin e festave zyrtare dhe fetare. - Përmirësim dhe pasurim i dekorit në qytet dhe Njësi administrative 						
c) Aktorët e mundshëm <ul style="list-style-type: none"> • Drejtoria e Shërbimeve Publike, ndjekjes së Investime dhe Infrastrukturës. • Administratorët e NjA 			d) Kontributet e mundshme në projekt (kush do të kontribuojë përkëtë projekt, financiarisht, etj.) Bashkia Shkodër Donatorët			
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2019		Totali (mije lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transf erime
A.1.1	Paga dhe sigurime	1 567	1 352	215		
A.1.2	Blerje aksesor dekorit për festat	1 400			1 400	
A.1.3	Blerje materiale të ndryshme për dekorin	350			350	
A.1.4	Blerje flamuj	250			250	
	Shuma	3 567	1 352	215	2 000	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2020		Totali (mije lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transf erime
A.1.1	Paga dhe sigurime	1 598	1 379	219		
A.1.2	Blerje aksesor dekorit për festat. materiale të ndryshme për dekorin, flamuj, etj.	2 000			2 000	
	Shuma	3 598	1 379	219	2000	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2021		Totali (mije lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Siguri me	Operative	Transf erime
A.1.1	Paga dhe sigurime	1 630	1 406	224		
A.1.2	Blerje aksesor dekorit për festat. materiale të ndryshme për dekorin, flamuj, etj.	2 024			2 024	
	Shuma	3 654	1 406	224	2 024	
f) Periudha e zbatimit Gjatë viteve 2019-2021		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Shërbimeve Publike, Ndjekjes së Investimeve të Infrastrukturës Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër				



Nr.5	P06260.O4.A1 Shërbimi i Mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbërta	Funksioni 6: Strehimi dhe komoditeti i komunitetit N/Funksioni 062: Zhvillimi i Komunitetit Llojet e programit: 06260: Shërbimet Publike Vendore		
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit				
I. Situata				
<p>A. Shërbimi i mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbërta.</p> <p>Gjatë vitit 2018 është kryer mirëmbajtjen e sipërfaqeve të gjelbërta dhe të gjelbërimit rrugor me sipërmarrje private për Shërbimi realizohet për mirëmbajtjen e 87 810m² sipërfaqe të gjelbër ,ku përfshihen 54 lulishte. Këto lulishte sipas rendësisë dhe sipërfaqeve përkatëse janë specifikuar sipas kategorive të sipërfaqeve të gjelbërta, tipi “A”, “B”, “C”. Shërbimet për mirëmbajtjen esipërfaqessëbarit, drurëve dekorativë, shkurreve, sipërfaqeve ujore, stolave, pastrim i rrugëve të brendshme etj kryhet sipas grafikëve të përcaktuar në funksin të tipologjive Elementet atraktiv të këtyre sipërfaqeve,</p> <p>Bazuar në grafikët e punimeve është punuar për rehabilitimin e sipërfaqes prej 6000 m2 në Zonën Industriale rruga Gjovalin Gjadri e cila do të mirëmbahet në vazhdimësi me të gjithë elementet e shërbimit. Në këtë rrugë janë mbjellë edhe 56 pemë me financim të dldp.</p> <p>Në bashkëpunim me bizneset e Zonës Industriale rruga Lëvizja e Postribës po rrealizohet përfundimi i rikonstruksionit të i sipërfaqes së trotuarëve. Bashkëpunimi ka konsistuar në kontributin e përfaqësuesve të biznesit për mbjlljen e 110 blinjeve dhe Bashkia investimin për rikonstruksionin e plotë të sipërfaqes me trotuate, gjelbërim e vendosje stolash.</p> <p>Në Nj.Ad Velipojë ka sipërfaqe të gjelbër (lulishte)për të cilën është realizuar shërbim mirëmbajtje sezonale.Shërbimi është realizuar në një sipërfaqe prej 17 000 m² lulishte dhe 491 m² sipërfaqe ujore (shatërvanet). Brenda kësaj sipërfaqeje ka dhe elementë të tjerë si, stola dekorativ 100 copë dhe drurë dekorativ 120copë, gjelbërim rrugor 78 rrënjë. Ky shërbim është realizuar me të njëjtin sipërmarrës, si qyteti</p> <p>Në Nj.Ad. Ana e Malit me investim të Bashkisë është realizuar një lulishteme sipërfaqe 200 m² në qendrën Oblikë, dhe gjelbërimi rrugor pranë doganës Muriqan me 143 rrënjë peme dekorative.</p> <p>Njëkohësisht realizohet dhe mirëmbajtja e gjelbërimit rrugor me 6272 rrënjë pemësh, dhe kjo për nga specifikat e lartesisë së pemëve është ndarë në tre kategori, të cilave i shërbehet sipas grafikëve të përcaktuar.</p> <p><u>Situata e vlerësuar:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> Dëmtimi i sipërfaqeve të lulishteve: Dëmtimi i stolave nga amortizimi, por edhe nga veprimet e qëllimshme nga persona tëpapërgjegjshem. Mungesa e infrastrukturës në lulishte për vendosjen e biçikletave. Mungesa e çesmave publike në lulishtet më tëfrequentuara nga banorët. Pengesat nga parkingjet për realizimin e shërbimeve tëpemëve në gjelbërimin rrugor. Ndotja e shatërvaneve, shpesh nga papërgjegjshmeria e qytetarëve që hedhin mbeturina nëto. Planifikimi i ndërhyrjes për riorganizimin e hapësirave të gjelbërta, duke u mbeshtetur ne kulturen dhe traditen e qytetit ne kultivimin e bimëve tradicionale. Në shumë njësi administrative gjelbërimi rrugor është i mangët. Në veçanti, zonat më të frequentuara nga qytetarët dhe vizitorët vendas dhe të huaj. Vështirësia në qarkullim në rrugët rurale nga prezenca e shkurreve dhe barërave në bankina 				
II. Synimi i projektit				
<p>-Realizimi të shërbimit të mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbra , për të gjithë Bashkinë me sipërmarrje private, me objektivin për të rritur sipërfaqe te gjelbërta për shërbim me 17 810 m² apo ndryshe, me 7 lulishte të reja , si dhe drurë vetë gjelbërimit rrugor me 1200 copë.</p> <p>Kryerje shërbimi në lulishte sipas tipologjive (A, B, C) të sipërfaqeve të gjelbra dhe gtrafikëve përkatës.</p> <p>E njëjta gjë dhe për gjelbërimin rrugor, shërbim i vecantëpërato, sipas lartesisë, poredhesipasrëndësisë, duke e ndarë në: gjelbërimrrugorstandartdhegjelbërimrrugorënhistorike.</p> <ol style="list-style-type: none"> Riorganizimi i sipërfaqeve të gjelbra nëkuadërtëpërmisimittëpeisazhit urban dhehistorik , sidhepërtëqënëfunktional përtëgjithëkomunitetin sidhe duke prezantuar me bimesisipastraditësdhekulturës së qytetit , trëndafilat, lule vjollë, kadife, etj. Ofrim i shërbimit mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbërta përtëgjithalulishtet e qytetit. Krijimi i sipërfaqeve të reja të gjelbra, me investime. Zgjerim i gjelbërimit rrugor në Nj.A, sipas prioriteteve. Shërbim periodik i mirëmbajtjes edhe për pika të rëndësishme turistike të qytetit, si rruga e Kalasë Rozafat, Bregu i liqenit dhe tek Ura e Mesit, sipas eventeve të ndyshme në këto dy zona. Mirëmbajtje e infrastruktures rrugore ne Nj.A , duke i pastruar ngabimësia e gjelbër. (shkurre, ferra, barërat e lartë.) Mirëmbajtje e bankinave të rrugëve dhe trotuarëve duke i pastruar ngabimësia e gjelbërt (bari). <p>Planifikimi për shërbimin në vitin 2019:</p> <table border="1" data-bbox="319 1960 1053 2000"> <tr> <td>Mirëmbajtje Sipërfaqe e Gjelbërt gjithë Bashkia</td> <td>37,326,000</td> </tr> </table>			Mirëmbajtje Sipërfaqe e Gjelbërt gjithë Bashkia	37,326,000
Mirëmbajtje Sipërfaqe e Gjelbërt gjithë Bashkia	37,326,000			




Investime	0
TOTAL	37,326,000

Mbulimi i kostove të shërbimit të gjelbërimit për vitin 2019 përllogaritet si më poshtë:

Familjet	Nr. i familjeve përfituese tëshërbimit	Nr. i mesatarizuar i familjeve që paguajnë (jane hequr familjet me lehtësi fiskale)	Tarifa e gjelbrimit	Të ardhurat nga tarifa gjelbrimit
Shkodër	35,425	15,783	600	9,470,000
TOTAL				9,470,000

Të ardhura nga biznesi	11,915,000
Të ardhurat nga institucionet	125,000
<u>TOTALI I TË ARDHURAVE TË PLANIFIKUARA</u>	<u>121,510,000</u>

Burimet e financimit për shërbimin e gjelbrimit



lii. Aktivitetet kryesore të projektit

Viti 2019

Hartimi i Planit të veprimit për shërbimin e gjelbërimit.
Mirëmbajtja dhe përmirësimi i sipërfaqeve të gjelbra me të gjitha elementët sipas kontratës me operatorin sipërmarrës
Realizimi i investimeve për krijimin e sipërfaqeve të reja të gjelbërta.
Realizimi i investimit për zgjerim të gjelbërimit rrugor
Hartim dhe vënie në zbatim e sistemit të monitorimit të standartizuar në kuadër të plotësimit të detyrimeve kontraktuale, apo detyrave të përcaktuara për strukturat publike të shërbimit.

Viti 2020– 2021

Sipas përcaktimeve afatmesme të Planit të veprimit për shërbimin e gjelbërimit:
Përmirësim i mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbra për të gjithë Bashkinë.
Rritje e investimeve për gjelbërimit rrugor në Nj.A.
Përmirësim i performancës së ofrimit të shërbimit të gjelbërimit përmes zbatimit dhe funksionimit të sistemit të monitorimit.

b) Rezultatet që prisni

Viti 2019 - 2021

Do të hartohet një plan i saktë veprimi për një periudhë afatmesme, i cili do të analizojë nevojat, kostot, dhe do të përcaktojë në kohë afatmesme synimet dhe indikatorët e matshëm për performancën e ofrimit të shërbimit.
Ofrimi i shërbimit të standartizuar për hapësirat e gjelbërta ekzistuese.
Rritje në përqindje dhe dendësi e sipërfaqeve të gjelbërta, funksionale në shërbim të qytetarëve të Shkodrës.
Rritje e performancës së ofrimit të shërbimit nëpërmjet një sistemi më efikas të matjes dhe monitorimit.

Shpenzimet për çdo aktivitet 2019	Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
		Pag a	Sigu rime	Oper ative	Tra nsf eri	Kap itale

						me	
A.1	Ofrim i shërbimit të gjelbërimit në Bashkinë e Shkodrës	37 326			3732	6	
	Shuma	37 326			3732	6	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2020		Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
